

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shpenzime për fiskalizimin për faturat”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Shërbime fiskale 79220000-2;

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 10.980.000 (dhjete milion e nentëqind e tetëdhjete mijë) **Lekë, pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 konkretisht në vlerën 219.600 (dyqind e nentëmbëdhjete mijë e gjashtëqind) lekë*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2.Kandidati/Ofertuesiduhet të dorëzojë**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”.*

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit, (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse dy nga bilancet nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Neni 43, pika 4, të VKM nr. 285 “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

**2.2.3.** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit);

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.*

*Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, citohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

2.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 e vlefshme. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- b) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën ISO 20000 mbi “Sistemet e menaxhimit të informacionit”, e vlefshme. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- c) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë ISO 27001 e vlefshme. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.*

*ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

*ISO 20000 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë të shërbimeve që kërkohen dhe lidhen me mirëmbajtjen e sistemeve. Ky lloj certifikimi garanton AK se operatori ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi.*

*ISO 27001 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e sigurisë së të dhënave dhe të shërbimeve që kërkohen. Ky lloj certifikimi garanton AK se operatori ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të sigurisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi.*

**2.5** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit me prodhuesin e sistemeve të specifikuar si mëposhte:

- Për Programin Kompjuterik të faturimit, *te përdorur nga UKT i cili kërkohet të integrohet;*
- Për Programin Kompjuterik ETL/DataIntegration, *i cili do të ofertohej;*

Autorizimi i prodhuesit kërkohet të jetë specifik për këtë procedurë prokurimi, duhet të drejtohet AK dhe të përmbajë referencat e procedurës. Dokumenti i autorizimit duhet të përmbajë kontraktet telefon, email apo tjetër të prodhuesit/distributorit të autorizuar në mënyrë që të mundesojë AK verifikimet e nevojshme.

**Argumentimi:** *Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për sistemet objekt prokurimi është vendosur në përputhje me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe mbrojtjes së interesit publik, si dhe lidhet drejtpërdrejt me objektin dhe natyrën e kontratës. Aktualisht, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a. përdor sistemin e faturimit Al-Billing, i cili përbën një komponent kritik të veprimtarisë së saj dhe është i integruar drejtpërdrejt me procesin e fiskalizimit të faturave. Për këtë arsye, kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar synon të garantojë se operatori ekonomik ofertues disponon të drejtat e nevojshme për ofrimin e shërbimeve, licencave dhe mbështetjes teknike për këto sisteme, si dhe se **ndërhyrjet** në sistem që realizohen në përputhje me kërkesat teknike dhe funksionale të Termave të Referencës do të kryhen në përputhje me përcaktimet teknike dhe politike të përcaktuara nga mbajtësi i të drejtave të autorit.*

*Autorizimi i prodhuesit shërben gjithashtu për të garantuar origjinalitetin e burimit dhe të produktit software-ik, duke siguruar që shërbimet dhe komponentët e përdorur janë produkte zyrtare, të ligjshme dhe të zhvilluara në kanale të autorizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale. Kjo kërkesë redukton rrezikun e përdorimit të zgjidhjeve të paautorizuara, kopjeve jo origjinale ose ndërhyrjeve që mund të cenojnë funksionalitetin, sigurinë, garancinë dhe mirëmbajtjen e sistemit.*

*Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, të dhënave që do të përpunohen, sensibilitetin dhe natyrën monetare. Kërkesat aplikohen për sistemet kryesore që përbëjnë pjesë thelbësore të projektit dhe ato lidhet drejtpërdrejt me aftësitë teknike, organizative dhe profesionale të operatorit ekonomik, si dhe me besueshmërinë e tij për përmbushjen me sukses të kontratës, duke i shërbyer autoritetit kontraktor për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe vazhdimësisë së shërbimit.*

**2.6** Operatorët ekonomikë duhet të zoteroje aftësitë/certifikimet për veprimtaritë dhe teknologjitë si mëposhte:

- Për Fiskalizimin e Fatures. *Zgjidhja software-ike e ofertuar duhet të jetë e certifikuar për veprimtarinë e fiskalizimit, si mëposhte:*
  - Me dhe pa para në dorë;
  - Pa para në dorë, e-invoice;
  - Faturë shoqëruese;
- Për Sisteme Cloud, në platformën e cila do të ofrohet.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe AKSHI, prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofrojnë, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara nga prodhuesit për dhënien e tyre.

**Argumentimi:** *Legjislacioni shqiptar, përcakton që sistemet e fiskalizimit duhet të jenë të Certifikuara nga Drejtoria e Pergjithëshme e Tatimeve si dhe AKSHI. Në bazë të Ligjit Nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit, të qarkullimit”, neni 16, pika 1. Përcaktohet “Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së ofrimit të zgjidhjeve software-ike ose shërbimeve të mirëmbajtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, prodhuesit dhe mirëmbajtësit e zgjidhjeve software-ike, duhet të regjistrohen në mënyrë elektronike në regjistrin e prodhuesve ose të mirëmbajtësve software-ike të AKSHI-t, duke përdorur platformën qendrore të faturave”. Për këtë edhe kërkimi i certifikimit nga Tatimet dhe AKSHI, përben një detyrim ligjor.*

*Sistemet kryesore në projekt janë kërkuar në Cloud. Lidhur me zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të mesiperme, prodhuesit e programeve informatike të mirënjohur ndërkombëtarisht, kanë ndërtuar programe trajnimi dhe kontrolli të shoqërive të cilat mundet të kryejnë shërbime që lidhen me zbatimin apo mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Në kuadër të këtyre programeve të certifikimit, prodhuesit vendosin kritere teknike nga pikepamja organizative, burimet njerezore të trajnuara/certifikuara për këto teknologji si dhe për procedurat e brendshme apo administrimin e informacionit të shoqërive. Këto programe/kushte certifikimi ndërtohen nga vetë prodhuesit dhe ata në këtë mënyrë marrin persiper cilësinë e shërbimeve të ofruara nga shoqëritë. Në shumë raste, kalimi i certifikimeve i kualifikon shoqëritë e IT si të autorizuar apo jo prej tyre për realizimin e shërbimeve të nderhyrjes, përmirësimit apo përditesimit të sistemeve. Nëse shoqëritë nuk kanë certifikime të prodhuesit (për infrastrukture) këto nderhyrje në sisteme rezikojnë përfundimin e kushteve të garancisë apo të mirëmbajtjes së prodhuesit.*

*Për këtë, certifikimi jo vetëm përbejnë një nevojë për garantimin e cilësisë së shërbimit por ato nga ana tjetër janë direkt të lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve për mirëmbajtjen. Nderhyrje në sisteme nga shoqëritë të pa-certifikuara mundet të demotojë vetë sistemin, të dhenat që mbahen në sisteme dhe/ose në kuadrin e sigurisë së informacionit mundet të behet shkak për aksesin apo demtimin e informacionit në persona apo drejtime të paautorizuara. Këtu duhet pasqyruar faktin e sensibilitetit të dhenave që mbahen në cloud, siguria në të dhëna financiare si dhe shpejtësia me të cilën kërkohet të operohen dhe procesohen të dhenat.*

*Kjo kërkesë i shërben AK për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses*

*të kontratës, duke garantuar funksionimin e sistemeve ne kushtet e garancisë pergjate te gjithe periudhes se kontrates. Per me shume, certifikimet e mesiperme, garantoje autoritetin Kontraktor qe sherbimet e perfshira ne kontrate do te levrohen jane ne perputhje me kerkesat e shoqerive prodhuese.*

*Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

---

**2.7.** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, prej të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të angazhohet në realizimin e shërbimeve objekt kontrate, si më poshtë:

a) 1 (nje) punonjës të çertifikuar për sistemin e faturimit ne perdorim prane UKT.

b) 1 (nje) punonjës të çertifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni web, ne teknologjine mbi te cilen ofrohet zgjidhja.

c) 1 (nje) punonjës të çertifikuar për sisteme rrjetash cloud, ne nivel profesional per infrastrukturen cloud qe do te ofertohe.

d) 1 (nje) punonjës të çertifikuar për baza të dhënash cloud, ne nivel profesional per bazen e te dhena qe do te perdoret te percaktuar ne terma te references.

d) 1 (nje) punonjës të çertifikuar për sisteme BI, per platforen qe do te perdoret, percaktuar ne terma te references.

Punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë pergjate 3 muajve te fundit.

*Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

b. Listëpagesën e 3 muajve të fundit.

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Konkretisht:**

a) Punonjësi i çertifikuar për sistemin al-billing i cili nevojitet për zhvillimin e billing per ndërlidhjen dhe mirëmbajtjen e sistemit te al-billing me sistemin e fiskalizimit. Duke qënë se faturat e UKT sh.a janë ne kete sistem al-billing, dhe kerkese e projektit eshte shkembimi operatori ekonomik duhet te kete personel te certifikuar, dhe te afte per te mundesuar lidhjen dhe automatizimin e shkembimeve te te dhenave te sistemit te faturimit al-billing.

b) Punonjësi i çertifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni nevojitet për zhvillimin e sistemit. Operatori duhet të jetë në gjëndje të përshtasë programin e fiskalizimit në komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga UKT.

c) Punonjësi i çertifikuar për sisteme në rrjeta cloud është i domosdoshëm për sigurimin e operimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe me disponueshmëri të lartë të sistemeve objekt kontrate. Duke marrë në konsideratë rëndësinë kritike të sistemit, konfidencialitetin e të dhënave që do të përpunohen, volumin e lartë të transaksioneve, si dhe kërkesën për realizimin e proceseve të fiskalizimit brenda afateve të shkurtra operative, kërkohet që ky certifikim të jetë në nivel profesional dhe jo bazik. Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pasi lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe rreziqet që mbart zbatimi i saj. Niveli profesional i certifikimit garanton njohuri të avancuara për administrimin e rjetit cloud, menaxhimin e performancës, sigurisë së informacionit, vazhdimësisë së shërbimit dhe rikuperimit nga incidentet, ndërkohë që certifikimet bazike mbulojnë vetëm njohuri hyrëse dhe nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme për administrimin e sistemeve kritike të këtij niveli. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të disponojë personel të certifikuar në teknologjitë cloud që përdoren realisht në zbatim të kontratës. Certifikimet duhet te jete ne teknologjite e perdorura.

d) Punonjësi i çertifikuar për bazë të dhënash cloud është i nevojshëm për ngritjen, ndërlidhjen dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave financiare që përmban sistemi. Kërkesa që certifikimi për administrimin e bazave të të dhënave cloud të jetë në nivel profesional dhe jo bazik është vendosur në zbatim të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pasi lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, rreziqet që mbart zbatimi i saj dhe garantimin e përmbushjes së suksesshme të kontratës. Duke marrë në konsideratë rëndësinë kritike të sistemit, volumin e madh të të dhënave financiare dhe fiskale, ndjeshmërinë e tyre, si dhe kërkesën për disponueshmëri të lartë dhe vazhdimësi të shërbimit, certifikimi në nivel profesional garanton njohuri të avancuara për administrimin e performancës, sigurisë së informacionit, rikuperimit nga incidentet dhe menaxhimin të mjediseve cloud. Certifikimet bazike mbulojnë vetëm njohuri hyrëse dhe nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme për administrimin e sistemeve kritike, ndaj nuk janë të përshtatshme për natyrën dhe përmasat e kësaj kontrate. Certifikimet duhet te jete ne teknologjite e perdorura.

e) Punonjësi i çertifikuar për sisteme raportimi BI i cili nevojitet për ngritjen raportimin dhe analizen e të dhënave mbi faturat. Ky certifikim kërkohet për teknologjinë të cilat do të përdoren në projekt. Duke qënë se faturat e e UKT sh.a janë të një volumi të rëndësishëm dhe cikli i përpunimit (raportimit të tyre në organet tatimore) është sa më e ulët, OE duhet të demonstrojë që ka personel të nevojshëm për zhvillimin e raportimit si dhe për mirëmbajtjen e support të këtyre raporteve. Certifikimet duhet të jete në teknologjitë e përdorura.

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, lidhur me produktet software/kompjuterike të gatshme duhet të paraqesë materiale/kataloge/datasheet teknike të prodhuesve. Katalogjet teknike kërkohe për produktet standarde të ofruara, minimalisht për sistemin e fiskalizimit, si dhe ETL/DataIntegration të ofertuar;

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e materialeve teknike të prodhuesit (katalogë teknikë) për produktet software/kompjuterike të gatshme që ofrohen për sistemin e fiskalizimit dhe ETL/Data Integration është vendosur për të garantuar transparencën, verifikueshmërinë dhe krahasueshmërinë objektive të ofertave, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Materialet teknike të prodhuesit shërbejnë për të vërtetuar se zgjidhjet e ofruara janë produkte standarde, të konsoliduara dhe funksionale, si dhe për të mundur vlerësimin e saktë të karakteristikave funksionale, arkitekturës teknike, kapaciteteve të integritetit, sigurisë, performancës dhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore të fiskalizimit dhe me nevojat operacionale të autoritetit kontraktor.

Kjo kërkesë i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë se produktet e ofruara mbështeten nga prodhuesi përkatës, janë të dokumentuara zyrtarisht dhe nuk përbëjnë zhvillime ad-hoc ose zgjidhje të paqëndrueshme, duke reduktuar rrezikun e mosfunksionimit, të ndërprerjes së shërbimit apo të pamundësisë së mirëmbajtjes afatgjatë. Njëkohësisht, paraqitja e katalogëve teknikë ndihmon në sigurimin e krahasimit të drejtë dhe të barabartë të ofertave, mbi baza teknike dhe funksionale, pa favorizuar asnjë operator ekonomik të caktuar.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që prokurohen dhe i shërben mbrojtjes së interesit publik, garantimit të cilësisë së shërbimit dhe përmbushjes së suksesshme të kontratës.

**Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

*shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Në specifikimet teknike (pjesë e DST-së) janë përcaktuar edhe arsyet e vendosjes të specifikimeve teknike.

## **Njësia e Prokurimit**